



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2093/ 11 Prot.

Datë 24.09.2025

V E N D I M
Nr. 1329 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.09.2025, mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1241/2025, datë 15.09.2025, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-56319-07-25-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, me fond limit:146,315,245 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.
Adresa: Rr.Lord Bajron, Nr.70, Laprakë, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK me Nipt, J61905015B, *Adresa: Fabrika e qelqit, Tiranë*

Operatori ekonomik “ALBANIA MOTOR COMPANY” ShPK me Nipt, K41829010I, *Adresa:Kashar, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 15.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1241/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-56319-07-25-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, me fond limit: 146,315,245 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.
 2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorite ekonomik “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
 3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
 4. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me Vendimin e KSHA-së dhe konstatimet e këtij vendimi duke publikuar në SPE shtojcën.
 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK dhe “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Nëpërmjet shkresës Nr. 561/1 prot., datë 22.09.2025, protokolluar me tonën nr. 2093/8 prot., datë 22.09.2025, me objekt “Kërkesë për Asistencë” autoriteti kontraktor, të Komisionit të Prokurimit Publikmbi problematika në zbatimin e vendimit për procedurën sipërcituar.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Nëpërmjet shkresës Nr. 561/1 prot., datë 22.09.2025, protokolluar me tonën nr. 2093/8 prot., datë 22.09.2025, me objekt “Kërkesë për Asistencë” autoriteti kontraktor, të Komisionit të Prokurimit Publik mbi problematika në zbatimin e vendimit për procedurën sipërcituar.

II.2. Referuar shkresës sipërcituar me objekt: “Kërkesë për Asistencë” për zbatim vendimi AK informon në mënyrë të përmbledhur si vijon: [...] QKUM pasi u njoh me vendimin më datë 08.09.2025 bëri rishikimet sipas këtij vendimi por e ka të pamundur të kryejë pezullim ose anulim të procedurë pasi ka skaduar koha ligjore për të kryer veprimet. Ditën e sotme duke tentuar përsëri për të zbatuar vendimin tuaj nuk e kishim të mundur të vepronim në sistem.... Duke pasur parasysh kohën e shkurtër që na ka ngelur në dispozicion për fondet si edhe nevojat urgjente për autoambulanca, lutemi një përgjigje nga ana juaj...[...]. ...]

II.3. Referuar shkresës sipërcituar si edhe verifikimeve në SPE, autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën mbi modifikim të dokumenteve të tenderit, sikurse citohet në Vendimin 1241/2025, datë 15.09.2025 të Komisionit si edhe bashkëlidhur shkresës nuk ka dërguar informacion apo shtojcë, mbi modifikimet e dokumenteve të tenderit mbi zbatimin e vendimit sipërshtuar.

Komisioni i Prokurimit Publik i ndodhur në këto kushte duke qenë se AK nuk ka publikuar shtojcë për modifikim të dokumenteve të tenderit si edhe për faktin që KPP ka dalë me vendimin nr. 1241/2025 mbi trajtimin e ankesave, cituar dispozitivi më sipër, si edhe ndodhur para një situatë të tillë, Komisioni gjykon, se Autoriteti Kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit, të dërgojë pranë KPP-së kopje të DST së re (shqip dhe anglisht) me ndryshimet përkatës, në përputhje me vendimin e KSHA-së dhe KPP-së për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligji nr. 162/2020 «Për Prokurimin Publik», i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 12.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor me vijimin me hapa të mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-56319-07-25-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, me fond limit: 146,315,245 Lekë pa

TVSH, për t'u zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

2. Autoritetin kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe të dërgojë në KPP, Setin e Dokumenteve të reja me ndryshimet përkatëse në zbatim të Vendimit 1241/2025, datë 15.09.2025.
3. Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin brenda 5–ditëve dhe të dokumentojë veprimet e kryera.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

